

UDHËZUES PËR PRINDËRIT DHE MËSUESIT

TIKTOK

Çfarë është TikTok?

TikToku është një aplikacion i njohur ku përdoruesit mund të shikojnë, krijojnë dhe ndajnë video të shkurtra me miqtë, familjen ose botën e jashtme. Aplikacioni është veçanërisht i popullarizuar në mesin e adoleshentëve dhe brezave të rinj.

- Aplikacioni përfshin mjete përpunimi, të cilat e lehtësojnë krijimin e përmbajtjes kreative
- Algoritmi i TikToku i ndihmon përdoruesit të zbulojnë video të përshtatura sipas interesave të tyre, gjë që shpjegon tërheqjen e tij të fortë dhe shtrirjen e gjerë.

A është TikTok-u i sigurt për fëmijët?

Si çdo platformë sociale, edhe TikToku mund të jetë i sigurt nëse përdoret me përgjegjësi. Aplikacioni përfshin cilësime sigurie dhe privatësie të përshtatura për grupmoshat e ndryshme.

- **Për fëmijët nën 13 vjeç**, TikToku ka një version të kufizuar të quajtur **TikTok për përdoruesit më të rinj**. Ky version ofron një përvojë të kufizuar shikimi, pa mundësinë për të postuar video ose për të bashkëvepruar me të tjerët, dhe përfshin përmbajtje që është e përshtatshme për moshën.
- **Adoleshentët e moshës 13 deri në 15 vjeç** kanë mbrojtje shtesë: profilet e tyre janë të vendosura si private si parazgjedhje, dhe vetëm ndjekësit e aprovuar mund ta shohin përmbajtjen e tyre. Ata gjithashtu nuk mund të dërgojnë ose marrin mesazhe me të huaj ose të kyçen drejtpërdrejt. Këto veçori janë krijuar për të kufizuar ekspozimin ndaj të huajve dhe për t'i ndihmuar ata të përdorin aplikacionin në mënyrë më të sigurt.

A janë profilet e TikTok publike apo private?

Profilet e TikToku për përdoruesit nën 16 vjeç janë automatikisht private. Me një profil privat, vetëm ndjekësit e aprovuar mund të shikojnë videot e tyre, të komentojnë mbi to ose të bashkëveprojnë me to.

Për përdoruesit e moshës 16 vjeç e lart, profilet janë vendosur si publike si parazgjedhje. Kushdo në TikTok mund ta shohë përmbajtjen e tyre - përveç nëse ndryshon në mënyrë manuale cilësimet e privatësisë.



Prindërit pyesin:

Si mund t'i mbroj fëmijët e mi?

TikTok-- ofron opsionin e lidhjes familjare, që u lejon prindërve dhe kujdestarëve të lidhin profilin e tyre me atë të fëmijës dhe ta mbikëqyrin gjatë përdorimit të aplikacionit.

Kujdesuni që adoleshenti juaj të dijë si të bllokojë këdo që e ngacmon, i kërcënohet ose e shqetëson në çfarëdo mënyre.

TikTok ofron lidhje familjare, që u mundëson prindërve dhe kujdestarëve të lidhin profilin e tyre TikTok me atë të adoleshentit për ta udhëhequr gjatë përdorimit të aplikacionit.

Prindërit mund të vendosin nëse fëmija i tyre mund të kërkojë përmbajtje, përdorues, këngë ose hashtag-e; të caktojnë kohën e kaluar para ekranit çdo ditë (40 deri në 120 minuta në ditë); të bëjnë profilin publik ose privat; të kufizojnë se kush mund të komentojë videot e tyre; të çaktivizojnë mesazhet direkte dhe të aktivizojnë 'Modalitetin e Kufizuar', që mund të limitojë përmbajtjen që mund të mos jetë e përshtatshme për ta.

Cilat janë sfidat e TikTok-ut?

Sfidat e TikTok-ut mund të jenë argëtuese, duke ofruar një ndjenjë përkatësie ndërsa përdoruesit bashkohen dhe ndajnë versionet e tyre të ngjarjes. Ato shpejt bëhen virale dhe janë një pjesë e madhe e kulturës së TikTok-ut.

Megjithatë, **jo të gjitha sfidat janë të sigurta**. Disa kërkojnë aftësi të veçanta ose marrjen e rreziqeve fizike, ndërsa të tjera mund të kalojnë kufijtë social ose emocional. Fatkeqësisht, disa sfida të rrezikshme kanë tërhequr vëmendjen e mediave, duke theksuar rëndësinë e mësimin të fëmijëve të mendojnë në mënyrë kritike para se të marrin pjesë.

Mënyra të tjera për të qëndruar të sigurt

Mjetet e Moderimit dhe Raportimit

Sipas Udhëzimeve të Komunitetit, TikToku përdor një kombinim të teknologjisë dhe reagimeve njerëzore (rishikimeve) për të hequr përmbajtjen që shkel politikat e saj. Megjithatë, ju gjithashtu mund të raportoni përmbajtje që mendoni se është e dëmshme, e papërshtatshme ose fyese. Inkurajoni fëmijën tuaj të raportojë çdo gjë që e bën të ndihet i/e pakëndshëm ose i/e pasigurt – edhe nëse nuk është i sigurt nëse ka shkelje të rregullave. Ja udhëzimet se si të raportoni probleme në aplikacion:

- Për të lënë një koment: Shtypni dhe mbani shtypur Komentin, pastaj prekni *Raporto*.
- Për të raportuar një video: Prekni shigjetën Ndaj, pastaj zgjidhni *Raporto*.
- Për të raportuar një profil: Shkoni te profili, prekni tre pikat në cep dhe zgjidhni *Raporto*.

Nxitja e menaxhimit të kohës dhe e ekuilibrit në jetë

TikToku mund të jetë argëtues dhe tërheqës - por si çdo aplikacion, është e lehtë të kalosh shumë kohë në të. Inkurajojeni fëmijën tuaj të bëjë pushime dhe të kalojë kohë vetëm me miqtë dhe familjen, duke bërë detyrat e shkollës, duke luajtur jashtë ose duke u angazhuar në aktivitete kreative dhe fizike. Ju mund të përdorni funksionet e menaxhimit të kohës për të kontrolluar kohën e kaluar para ekranit, të cilat përfshijnë:

- Cilësimet e kohës para ekranit të TikTok, të cilat u lejojnë përdoruesve të vendosin kufij ditor dhe të marrin njoftime për të bërë pushime.
- Karakteristikat e integruara të telefonit si **Koha para ekranit e Apple** ose **Mirëqenia Digjitale e Android**, të cilat ndihmojnë në monitorimin dhe menaxhimin e përdorimit të aplikacionit.

Balancimi i kohës para ekranit ndihmon në mbrojtjen e shëndetit mendor të fëmijës suaj dhe mban prioritetet dhe marrëdhëniet e tjera në fokus.

Shënim në lidhje me kontrollin prindëror. Kontrollat prindërore kanë vendin e tyre, por ndonjëherë bisedat e drejtpërdrejta mund të kenë një ndikim më të madh.

Ky projekt është financiar me mbështetjen e Komisionit Evropian. Përmbajtja e tekstit pasqyron vetëm qëndrimet e autorit, dhe Komisioni Evropian nuk mban asnjë përgjegjësi për përdorimin e mundshëm të informacionit të përfshirë në të.



Për më shumë
informacione, vizitoni
faqen tonë të
internetit:
www.mksafenet.mk



Prindërit mund ta
aktivizojnë
“Modalitetin e
Kufizuar” për të
limituar qasjen te
përmbajtja që mund
të mos jetë e
përshtatshme për të
gjitha moshat!

